PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	1-4
PASQYRAT FINANCIARE :	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	7
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	8
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	9 – 27

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
AKTIVET			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	5	2,432,525,236	2,462,935,017
Aktivet afatgjata jomateriale	6	79,373,608	42,641,864
Aktive afatgjata financiare	7	450,000,000	450,000,000
Llogari të arkëtueshme të tjera	8	-	3,869,880
Totali aktiveve afatgjata		**2,961,898,844**	**2,959,446,761**
Aktivet afatshkurtra			
Inventarët	9	158,423,518	206,692,507
Llogari të arkëtueshme tregëtare	10	720,987,132	619,089,898
Llogari të arkëtueshme të tjera	11	417,747,988	396,158,882
Mjete Monetare	12	2,735,567,874	2,531,956,130
Totali aktiveve afatshkurtra		**4,032,726,512**	**3,753,897,417**
TOTALI I AKTIVEVE		**6,994,625,356**	**6,713,344,178**
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali			
Kapitali aksionar		3,008,624,000	1,642,447,000
Rezerva nga rivlerësimi		1,254,418,327	1,320,891,974
Rezerva ligjore		114,735,189	114,735,189
Rezerva të tjera		127,233	1,239,614,352
Fitime/Humbje të pashpërndara		76,444,694	(319,605,085)
Fitime/Humbje të ushtrimit		42,834,174	(3,831,541)
Totali i kapitalit	13	**4,497,183,617**	**3,994,251,889**
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Tatim i shtyrë	28	175,253,247	185,224,294
Të tjera detyrime afatgjata	14	-	450,000,000
Totali detyrimeve afatgjata		**175,253,247**	**635,224,294**
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	15	437,446,030	529,381,638
Detyrime tatimore	16	39,745,370	92,178,123
Detyrime ndaj punonjësve	17	8,204,390	7,055,109
Grante dhe të ardhura të shtyra	18	12,696,548	9,035,308
Llogari të pagueshme të tjera	19	1,824,096,154	1,446,217,817
Totali detyrimeve afatshkurtra		**2,322,188,492**	**2,083,867,995**
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		**6,994,625,356**	**6,713,344,178**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 - 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e të Ardhurave Gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura	20	2,306,948,700	2,230,064,423
Të ardhura të tjera jo operative	21	4,519,615	369,185
Materiale të para dhe të konsumueshme	22	(224,087,061)	(238,930,187)
Shpenzime personeli	23	(1,156,616,351)	(1,172,368,294)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	24	(178,275,478)	(270,679,973)
Shpenzime të tjera	25	(686,308,664)	(550,619,699)
Fitimi Operativ		**66,180,761**	**(2,164,545)**
Te Ardhura/ Shpenzime financiare Neto	26	14,120,482	44,430,676
Total shpenzime financiare		**14,120,482**	**44,430,676**
Fitimi para Tatimit		**80,301,243**	**42,266,131**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin aktual	27	(37,467,069)	(55,193,143)
Fitimi neto i Vitit		**42,834,174**	**(12,927,012)**
Tatim fitime të shtyrá nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	28	9,971,047	9,095,471
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		**9,971,047**	**9,095,471**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		**52,805,221**	**(3,831,541)**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 - 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali aksionar	Rezerva te tjera	Rezerva ligjore	Rezerva nga rivleresimi	Fitime te mbartura /humbje te akumuluara	Totali
Pozicioni financiar më 1 Janar 2015	**1,642,447,000**	**1,044,369,902**	**103,250,221**	**1,380,951,365**	**(149,965,123)**	**4,021,053,365**
Fitimi i vitit					(12,927,012)	**(12,927,012)**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse				-	9,095,471	**9,095,471**
Rimarrje rezerva rivlerësimi				(60,059,391)	60,059,391	-
Dividendë të paguar					(22,969,935)	**(22,969,935)**
Transferim në rezervën ligjore dhe të tjera		195,244,450	11,484,968		(206,729,418)	-
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2015	**1,642,447,000**	**1,239,614,352**	**114,735,189**	**1,320,891,974**	**(323,436,626)**	**3,994,251,889**
Fitimi i vitit					42,834,174	**42,834,174**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse					9,971,047	**9,971,047**
Rimarrje rezerva rivlerësimi				(66,473,647)	66,473,647	-
Zmadhim i kapitalit me fonde të tjera	450,000,000					**450,000,000**
Kontribute në natyrë		126,507				**126,507**
Transferim për zmadhime të kapitalit	916,177,000	(1,239,613,626)			323,436,626	-
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2016	**3,008,624,000**	**127,233**	**114,735,189**	**1,254,418,327**	**119,278,868**	**4,497,183,617**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen sëbashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 - 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhimi më ____ Maj 2017 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Z.Majlind Lazimi
Drejtor i Përgjithshëm

Z.Redvin Marku
Dr/Drejtorisë Ekonomike dhe Financës

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		**80,301,243**	**42,266,131**
Axhustime për zërat jo-monetare:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi		178,275,478	270,679,973
Nxjerrja jashtë përdorimit e Mjeteve fikseve, neto nga fitimi kapital		10,642,751	3,555,262
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues		**269,219,472**	**316,501,366**
Ndryshimi në kapitalin qarkullues			
Ndryshimi në inventar		48,268,989	174,647
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme dhe të tjera		(53,612,525)	182,022,420
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera		234,659,257	(162,342,022)
Ndryshimi në grante dhe të ardhura të shtyra		3,661,240	(1,858,773)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		**502,196,433**	**334,497,638**
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		(103,471,004)	(9,846,784)
Mjetet monetare Neto te gjeneruara nga aktivitetet operative		**398,725,429**	**324,650,854**
Aktivitetet investuese			
Blerje të aktiveve afatgjata materiale		(145,263,685)	(124,098,429)
Blerje të aktiveve afatgjata jomateriale		(49,850,000)	(10,973,106)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues		**(195,113,685)**	**(135,071,535)**
Aktivitetet financuese			
Dividendë paguar		-	(22,969,935)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues		**-**	**(22,969,935)**
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		**203,611,744**	**166,609,385**
Mjetet monetare në fillim të periudhës		2,531,956,130	2,365,346,745
Mjetet monetare në fund të periudhës	**12**	**2,735,567,874**	**2,531,956,130**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 - 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Posta Shqiptare sh.a është krijuar si shoqëri anonime me Vendim të Gykatës së Rrethit Tiranë Nr. 20718 datë 03/02/1992. Aksioner i Shoqërisë është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit 7638 datë 19.11.1992, "Për shoqëritë Tregtare" dhe në vijim nga ligji Nr.9901 dt 14.04.2008, si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Shoqëria është gjithashtu institucion financiar jobankar i liçensuar si e tillë nga Banka Qëndrore dhe raporton në mënyrë specifike për këtë qëllim.
Shoqëria kryen aktivitetin e saj në ambjente që janë në pronësi të saj. Aktivet e qëndrueshme pronë e saj përbëhen nga toka, ndërtesa, pajisje informatike, mjete transporti etj. Kapitali i Shoqërisë sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë përbëhet nga kontributet e aksionerit të vetëm, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në shumën 1,642,447,000 lekë, i ndarë në 1.642.447 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secili, të cilat zotërohen 100% nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
Shoqëria Posta Shqiptare sh.a drejtohet nga Këshilli Mbikqyrës, i cili ka emëruar si Administrator të përgjithshëm Z. Majlind Lazimi.

Këshilli Mbikqyrës:

Emri	Funksioni
Adela Karapici	Kryetar
Irena Malolli	Anëtar
Hasan Hoxha	Anëtar
Diana Dervishi	Anëtar
Marinela Lika	Anëtar
Ergys Qirici	Anëtar

Selia e shoqërisë është Rruga Rreshit Collaku Tiranë. Shoqëria është e regjistruar si person juridik ne Degën e Tatimpaguesve të Mëdhenj me NIPT J61924007N.

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhën aktuale

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme aplikohen në periudhat e raportimit financiar që fillojnë me ose pas datës 1 janar 2016.

- Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me interesat në njësitë e tjera ekonomike" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - Njësitë investuese: Aplikimi i përjashtimit të konsolidimit - miratuar nga BE-ja më 22 shtator 2016 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në SNRF 11"Marrveshjet e përbashkëta"- Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operacione të përbashkëta - të miratuar nga BE-ja më 24 nëntor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" Paraqitja Fillestare - miratuar nga BE-ja më 18 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në SNK 16 "Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje"- Sqarimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit - të miratuara nga BE-ja më 2 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"- Përcaktimi i planeve përfituese: Kontributet e punonjësve - të miratuara nga BE-ja më 17 dhjetor 2014 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 shkurt 2015).

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhën aktuale (vazhdim)

- Ndryshimet në SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"- Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta - e miratuar nga BE-ja më 18 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2010-2012)" që rezultojnë nga projekti për përmirësimin vjetor të SNRF (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin - miratuar nga BE-ja më 17 dhjetor 2014 (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 shkurt 2015).

Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2012-2014)" që rezultojnë nga projekti për përmirësimin vjetor të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin - miratuar nga BE-ja më 15 dhjetor 2015 (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emetuar por nuk janë ende efektive:

- SNRF 9 "Instrumentat Financiar" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- SNRF 15 "Të ardhurat nga Kontratat me Klientët" dhe amendime të mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- SNRF 16 "Qiratë" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019)
- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione" (Klasifikimi dhe matja e pagesës të bazuar në aksione (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit"- Aplikimi I SNRF 9 "Instrumentat Financiar" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentat Financiare aplikohet për herë të pare).
- Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta"- Shitja ose Kontributi aseteve ndërmjet një investitori dhe ortakut ose sipërmarrjet e përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Flukseve Monetare"- Paraqitja fillestare (efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2017)
- Ndryshimet në SNK 12 "Tatimi mbi të ardhurat"- Njohja e detyrimeve tatimore të shtyrë për humbjet e parealizuara (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2017)
- Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara"- Transferimet e aktiveve afatgjata materiale të investuara (efektive per periudhat vjetore që fillojne më ose pas 1 Janarit 2018)
- Ndryshime të standarteve të ndryshme "Përmirësime të SNRF-ve (cikli 2014-2016)" që rrjedhin nga projekti vjetor i përmiresimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12, IAS 28) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (Ndryshimet në SNRF 12 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017 dhe ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018)
- SIC 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe parapagimet" (për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

3. Bazat e përgatitjes

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") te BSNK-se.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

3.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

3.5.3. Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe ne llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

3.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
EUR/Lek	135.23	137.28
USD/ Lek	128.17	125.79
CHF/Lek	126.05	126.74
GDP/Lek	157.56	186.59
SDR/Lek	171.76	174.46

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.
Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kompensimi instrumentave financiare
Aktivet dhe pasivet financiare kompensohen dhe paraqiten neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe qëllimi që shlyerja të realizohet mbi baza neto, apo të realizohet aktivi dhe te shlyhet detyrimi njëkohësisht. Kjo vlen kryesisht për balancat ndaj/dhe nga operatorët e tjerë të telekomunikacioneve kombëtare dhe nderkombëtare, të cilat shlyhen në shumën neto, në përputhje me kontratat ekzistuese.

4.3. Inventarët

Inventarët njihen me vlerën më të voglën mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme.
Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përllogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit minus kostot e përllogaritura për përfundimin dhe realizimin e shitjes. Kostot e inventarit janë përllogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

4.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.
Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proçes" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.
Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.
Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.4. Aktive afatgjata material (vazhdim)

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur.
Amortizimi njihet në bazë të vlerës së mbetur, duke përdorur normat e përcaktuara nga manxhimi.

Aktivet afatgjata materiale	Norma e amortizimit %	
	2016	2015
Ndërtesa	5	5
Makineri e pajisje	20	20
Mjete transporti	20	20
Mobilje dhe orendi	20	20
Pajisje elektronike	25	25

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proçes.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.
Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë liçensat dhe të drejtat për përdorim.

Njohja dhe Matja
Liçencat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me vleren e drejte minus amotizimin e akumuluar (shihni më poshtë) dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet e mëpasshme
Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike për aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim/humbje kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirese duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve jomateriale që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

Aktivet jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi vlerën e drejtë.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.6. Zhvlerësimi (Rënia në vlerë)

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin e aktiveve. Në rast se evidentohen tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Për aktivet jomateriale që nuk janë të gatshme për përdorim, vlera e rikuperueshme përllogaritet në çdo datë të bilancit.
Një humbje nga zhvlerësimi njihet atëherë kur vlera e mbartur e aktivit apo njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është njësia më e vogel e identifikueshme e grupit të aktiveve e cila gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimet njihen në fitim/humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo një njësie që gjeneron flukse paraje është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Për të vlerësuar vlerën në përdorim, flukset e ardhshme monetare të çmuara aktualizohen duke përdorur normën para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

4.7. Të ardhurat

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në Shoqëri dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur bëhet pagesa. E ardhura matet me vlerë të drejtë të shpërblimit të marrë për shërbimin e kryer dhe mallrat e shitura, neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe zbritje të mundshme të shitjeve.

4.8. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjatë të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.9. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

4.10. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.
Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.11. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.
Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

4.12. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

4.13. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.14. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.15. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

5. Aktivet afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri & Pajisje	Mjete transporti	Mobilje e Orendi	Pajisje informatike	AQT në Proçes	Totali
Kosto								
Gjendja më 1 Janar 2015	379,999,919	1,895,473,454	107,363,505	61,391,011	186,235,725	354,910,903	2,690,000	**2,988,064,517**
Shtesa	-	-	2,100,251	47,099,562	27,401,251	10,969,275	36,528,090	**124,098,429**
Pakësime	-	-	(1,077,866)	(722,615)	(4,520,206)	(645,796)	-	**(6,966,483)**
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	**379,999,919**	**1,895,473,454**	**108,385,890**	**107,767,958**	**209,116,770**	**365,234,382**	**39,218,090**	**3,105,196,463**
Shtesa	-	33,893,543	14,504,913	40,060,333	1,898,695	2,244,117	52,662,084	**145,263,685**
Pakësime	-	-	(1,375,548)	(120,306)	(8,988,787)	(3,990,413)	-	**(14,475,054)**
Sistemime	-	-	(6,775,118)	(853,579)	7,726,828	(1,065,722)	-	**(967,591)**
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	**379,999,919**	**1,929,366,997**	**114,740,137**	**146,854,406**	**209,753,506**	**362,422,364**	**91,880,174**	**3,235,017,503**
Amortizimi i akumuluar								
Gjendja më 1 Janar 2015	-	184,809,181	29,346,086	18,840,861	57,383,687	169,397,460	-	**459,777,275**
Amortizimi i vitit	-	85,673,021	13,426,340	11,727,327	26,488,052	48,985,944	-	**186,300,684**
Pakësime	-	-	(392,276)	(465,626)	(2,067,791)	(485,528)	-	**(3,411,221)**
Sistemime	-	-	-	-	-	(405,292)	-	**(405,292)**
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	**-**	**270,482,202**	**42,380,150**	**30,102,562**	**81,803,948**	**217,492,584**	**-**	**642,261,446**
Amortizimi i vitit	-	81,249,599	15,839,744	20,553,312	25,500,027	22,014,534	-	**165,157,216**
Pakësime	-	-	(822,291)	(37,368)	(4,264,062)	(2,152,907)	-	**(7,276,628)**
Sistemime	-	-	-	2,405,027	(3,600)	(51,194)	-	**2,350,233**
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	**-**	**351,731,801**	**57,397,603**	**53,023,533**	**103,036,313**	**237,303,017**	**-**	**802,492,267**
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	**379,999,919**	**1,624,991,252**	**66,005,740**	**77,665,396**	**127,312,822**	**147,741,798**	**39,218,090**	**2,462,935,017**
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	**379,999,919**	**1,577,635,196**	**57,342,534**	**93,830,873**	**106,717,193**	**125,119,347**	**91,880,174**	**2,432,525,236**

6. Aktive afatgjata jomateriale

Balanca e aktiveve afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 Janar 2015	54,289,207	**54,289,207**
Shtesa	10,973,106	**10,973,106**
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	**65,262,313**	**65,262,313**
Shtesa	49,850,000	**49,850,000**
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	**115,112,313**	**115,112,313**
Amortizimi		
Gjendja më 1 Janar 2015	13,558,579	**13,558,579**
Amortizimi i vitit	8,656,578	**8,656,578**
Sistemime	405,292	**405,291**
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	**22,620,449**	**22,620,449**
Amortizimi i vitit	13,118,258	**13,118,258**
Sistemime	-	-
Zhlverësimi i vitit	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	**35,738,706**	**35,738,706**
Gjendja neto më 31 Dhjetor 2014	**40,730,628**	**40,730,628**
Gjendja neto më 31 Dhjetor 2015	**42,641,864**	**42,641,864**
Gjendja neto më 31 Dhjetor 2016	**79,373,607**	**79,373,608**

7. Aktive afatgjata financiare

Aktivet afatgjata financiare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Investime në shoqërinë Albtelecom	450,000,000	450,000,000
	450,000,000	**450,000,000**

8. Llogari të arkëtueshme të tjera afatgjata

Gjendjet e llogarive të arkëtueshme të tjera afatgjatë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Garanci për qera	-	3,869,880
	-	**3,869,880**

9. Inventari

Gjendjet e inventarit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Materiale të para	14,471,010	10,785,082
Materiale ndihmëse	73,927,272	127,686,415
Lëndë djegëse	12,167,734	8,217,263
Pjesë këmbimi	6,067,224	6,260,548
Inventar i Imët	50,017,036	51,658,002
Mallra për shitje	1,773,242	2,085,197
	158,423,518	**206,692,507**

10. Llogari të arkëtueshme tregtare

Balanca e llogarive të arkëtueshme tregtare të shoqërisë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Klientë për shitje e shërbime	651,854,698	562,742,705
Klientë ndërkombëtar	69,132,434	56,347,193
Zhvlerësimi i kërkesave për arkëtim		
	720,987,132	**619,089,898**

11. Llogari të tjera të arkëtueshme

Gjendja e llogarive të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohet si më poshtë :

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Të arkëtueshme nga Banka e Shqipërisë për Bono Thesari	123,650,000	182,972,355
Tatim fitimi i parapaguar	26,479,107	15,351,192
TVSH e parapaguar Interposta	58,285,911	54,049,239
Të drejta ndaj personelit	82,239,898	55,295,775
Debitorë të tjerë marrëdhënie me sportelin	40,627,709	28,564,668
Të tjera kërkesa	86,465,363	59,925,653
	417,747,988	**396,158,882**

12. Mjete monetare

Balanca e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Mjete monetare në bankë	1,832,321,331	1,745,020,358
Llogari rrjedhëse	*1,579,977,103*	*1,595,418,268*
Depozita me Afat	*252,344,228*	*249,602,090*
Mjete monetare në arkë	716,604,844	593,730,417
Likuiditete të tjera	186,641,699	193,205,355
	2,735,567,874	**2,531,956,130**

13. Kapitali

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Kapitali aksionar	3,008,624,000	1,642,447,000
Rezerva nga rivlerësimi	1,254,418,327	1,320,891,974
Rezerva ligjore	114,735,189	114,735,189
Rezerva të tjera	127,233	1,239,614,352
Fitime/Humbje të pashpërndara	76,444,694	(319,605,085)
Fitime/Humbje të ushtrimit	42,834,174	(3,831,541)
	4,497,183,617	**3,994,251,889**

14. Detyrime të tjera afatgjata

Detyrimet e tjera afatgjata më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Detyrime të tjera afatgjata	-	450,000,000
	-	**450,000,000**

15. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Detyrime ndaj furnitorëve vendas	380,271,246	463,021,345
Detyrime ndaj furnitorëve të huaj	57,174,784	63,801,553
Furnitorë për fatura të pambëritura	-	2,558,740
	437,446,030	**529,381,638**

16. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të Shoqërisë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 vijojnë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Detyrime për sigurime shoqërore	23,957,605	23,753,075
Tatim mbi të ardhurat personale	2,150,030	5,691,950
TVSH për t'u paguar	13,528,237	7,539,955
Tatim në burim	109,498	-
Tatimi mbi fitimin		55,193,143
	39,745,370	**92,178,123**

17. Detyrimet ndaj personelit

Detyrimet ndaj personelit të Shoqërisë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 vijojnë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Detyrime për paga	8,204,390	7,055,109
	8,204,390	**7,055,109**

18. Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime

Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë :

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Të ardhura të shtyra	12,696,548	9,035,308
	12,696,548	**9,035,308**

19. Llogari të pagueshme të tjera

Llogaritë e tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Detyrime për bono thesari	123,650,000	182,972,356
Detyrime për pensione	839,111,723	593,884,331
Detyrime për shërbimin ndërkombëtar	57,134,116	63,801,553
Marrëdhënie me doganat	77,741,225	-
Detyrime të tjera	726,459,090	605,559,577
	1,824,096,154	**1,446,217,817**

20. Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga shërbime postare	1,058,028,227	1,005,016,485
Të ardhura nga shërbime financiare	960,114,866	942,391,957
Të ardhura nga shërbime telefonike	2,240,134	452,308
Të ardhura nga shërbime biznesi	39,284,984	35,658,238
Të ardhura nga shërbimi ekspres	80,312,120	81,694,101
Të ardhura nga shërbimi ndërkombëtar	166,968,369	151,976,223
Të ardhura nga eksporti	-	7,965,715
Te ardhura realizuar nga Interposta	-	4,909,396
	2,306,948,700	**2,230,064,423**

21. Të ardhura të tjera jo operative

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga qeraja	-	67,440
Të ardhura të tjera	4,519,615	301,745
	4,519,615	**369,185**

22. Materiale të para dhe të konsumueshme

Materiale të para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Materiale të konsumuara	90,407,677	118,577,636
Kosto e pullës	15,022,383	21,181,908
Konsumi i inventarit të imët	14,620,378	3,980,799
Shpenzime karburanti	39,500,772	42,844,302
Koefiçienti i kreditimit	64,535,851	52,345,542
	224,087,061	**238,930,187**

23. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime për paga	982,131,200	984,918,160
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	171,496,652	165,380,341
Shpërblime për punonjësit	2,988,499	22,069,793
	1,156,616,351	**1,172,368,294**

24. Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi

Shpenzimet e amortizimit dhe zhvlerësimit për vitin 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime amortizimi	178,275,478	194,957,262
Shpenzime zhvlerësimi	-	75,722,711
	178,275,478	**270,679,973**

25. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime për energji elektrike dhe uje	28,557,931	32,412,965
Blerje sherbim internet Interposta	21,178,360	63,637,809
Berje materiale interposta	-	-
Shpenzime qeraje	48,567,703	33,280,552
Shpenzime për mirëmbajte dhe riparime	60,516,363	49,592,373
Shpenzime siguracioni	1,057,317	2,036,736
Shpenzime për udhëtime dhe dieta	25,711,633	18,387,344
Shpenzime telefonike	4,680,776	5,790,076
Shpenzime personel i jashtëm	6,668,974	10,332,185
Shpenzime për reklama dhe publicitet	434,330	5,097,679
Shpenzime transport	6,734,467	7,672,742
Shpenzime për ruajte objektesh	68,827,733	34,262,623
Shpenzime për komisione bankare	37,410,118	35,520,771
Shpenzime për sponsorizime	8,177,514	1,455,667
Shpenzime për agjent postar	27,986,465	-
Shpenzime postare ndërkombëtare	105,780,516	112,219,963
Shpenzime pritje, dhurata	7,447,882	6,202,367
Shpenzime gjoba dhe penalitete	102,663,808	86,400,182
Shpenzime për taksa	90,904,174	13,439,879
Vlera e mbetur e AAM-ve të dala	9,411,507	3,902,619
Shpenzime për liçensa/kuotizacione	2,551,174	30,000
Shpenzime të tjera	21,039,919	28,945,167
	686,308,664	**550,619,699**

26. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhura dhe shpenzime financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga interesat	3,708,194	6,089,093
Të ardhura nga këmbimet valutore	27,093,778	43,862,314
Të ardhura të tjera financiare	272,933	3,983,075
Të ardhurat financiare	**31,074,905**	**53,934,482**
Humbje nga këmbimet valutore	(2,782,182)	(9,407,175)
Shpenzime të tjera financiare	(14,172,241)	(96,631)
Shpenzimet financiare	**(16,954,423)**	**(9,503,806)**
Rezultati financiar	**14,120,482**	**44,430,676**

27. Tatimi mbi fitimin

Përllogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Fitimi para tatimit	**80,301,243**	**221,494,712**
Shpenzime të panjohura	169,479,217	146,459,573
Shpenzime amortizimi	66,473,647	60,059,391
Shpenzime pritje përcjellje	660,341	
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	101,082,214	86,400,182
Shpenzime dhurata e sponsorizime	1,263,015	
Total fitimi i tatueshëm	**249,780,460**	**367,954,285**
Humbje fiskale e mbartur	-	
Baza e llogaritjes	**249,780,460**	**367,954,285**
Shpenzime tatim mbi fitimin aktual	**37,467,069**	**55,193,143**

28. Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë i përllogaritur për vitin 2016 dhe 2015 lidhet me sa më poshtë:

	Pasqyra e Pozicionit financiar		Pasqyra e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	
	31 dhjetor 2016	**31 dhjetor 2015**	**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**	**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**
Rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale	175,253,247	185,224,294		
Te ardhura/(shpenzime) tatimi te shtyre			9,971,047	9,095,471
Aktive/(pasive) tatimore te shtyra	175,253,247	185,224,294		

29. Instrumentat financiarë dhe manaxhimi i riskut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një sërë risqesh financiare si: risku i kreditit, risku i likuiditetit dhe risku nga monedhat e huaja. Shoqëria nuk perdor instrumenta financiarë derivativë ose ndonjë formë tjetër mbrojtje ndaj këtyre risqeve.

Nuk ekziston një kuadër i mirëfilltë formal i implementuar nga shoqëria për manaxhimin e riskut. Manaxhimi i shoqërisë fokusohet më shumë në riskun e kreditit dhe riskun e likuiditetit dhe vepron rast pas rasti për të zbutur këto risqe dhe për të minimizuar humbjet.

29. Instrumentat financiarë dhe manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Objektivat dhe politikat e manaxhimit të riskut financiar

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon të drejta për të marrë para ose asete të tjera financiare nga palët e tjera ose detyrimin për të dhënë asete të tjera financiare një palë tjetër. Instrumentat kryesore financiare të Shoqërisë konsistojnë në para në dorë dhe në bankë, hua ndaj palëve të lidhura, llogari tregtare të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera financiare. Instrumentat financiare krijojnë një risk për shoqërinë. Risqet më të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria janë si vijon:

29.1. Risku i Likuiditeteve

Shoqëria gjeneron flukse të mëdha të parasë nga aktivitetet operative (psh nga mbledhja e kërkesave të arkëtueshme) në atë masë sa që beson se rreziku i likuiditeteve nuk është domethënës.

29.2. Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku qe vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Kompania nuk është e ekspozuar nga risku i normave të interesit.

29.3. Risku nga monedhat e huaja

Risku nga monedhat e huaja është risku që vlera e instrumentave financiare do të luhatet si pasojë e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja. Manaxhimi nuk është futur në ndonjë derivat për t'i vënë kufi këtij risku.

29.4. Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikësëpari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.
Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

30. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore
Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore
Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

31. Ngjarje pas datës së raportimit

Më 31 dhjetor 2016 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.